

FOL

KOMUNAT NUK ZBATOJNË UDHËZIMIN ADMINISTRATIV TË MAPL-SË NR.02/2019



KOMUNAT NUK ZBATOJNË UDHËZIMIN ADMINISTRATIV TË MAPL-SË NR.02/2019

MARS, 2022

Titulli: Komunitat nuk zbatojnë Udhëzimin Administrativ të MAPL-së nr.02/2019

Viti i botimit: Mars 2022

Publikuar nga: Lëvizja FOL

Andrea Gropa nr.35

Prishtinë 10000, Republika e Kosovës

info@levizjafol.org

+383 (0)49 131 542



Të drejtat e autorit © 2022. Lëvizja FOL. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes së të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë elektronike, mekanike, fotokopjuese, incizuese apo tjetër, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga ana e botuesit.

Ky raport është realizuar me mbështetjen financiare të Rockefeller Brothers Fund, përmbajtja e së cilës është përgjegjësi vetëm e Lëvizjes FOL dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e RBF-së.

PËRMBAJTJA

Hyrje.....	4
Metodologjia.....	5
Korniza ligjore.....	5
Këshillat lokal në komunat deri në 10,000 banorë.....	6
Këshillat lokal në komunat me 10,001 deri në 20,000 banorë.....	7
Këshillat lokal në komunat nga 20,001 deri në 30,000 banorë.....	8
Këshillat lokal në komunat nga 30,001 deri në 50,000 banorë.....	9
Këshillat lokal në komunat nga 70,001 deri në 100,000 banorë.....	11
Këshillat lokal në komunat me mbi 100,001 banorë.....	12
Këshillat lokal në Kryeqytetin e Kosovës.....	14
Përfundime.....	15

HYRJE

Lëvizja FOL, me mbështetjen e Rockefeller Brothers Fund (RBF) është duke implementuar projektin “Improving Local Governance through Civic Engagement”, projekt ky që synon forcimin e praktikës demokratike dhe ndërtimin e institucioneve publike, transparente dhe të përgjegjshme ndaj nevojave të qytetarëve. Përmes këtij projekti, Lëvizja FOL është duke analizuar akterët lokal dhe kornizat tashmë ekzistuese institucionale dhe ligjore.

Ndërmjet forumeve të diskutimit “FOL Hapur”, FOL synon të ofroj platforma të sigurta në mënyrë që këshillat lokal të bëhen akterë i rëndësishëm në identifikimin e nevojave dhe kërkesave të qytetarëve. Bazuar në këto diskutime dhe mbështetur në të dhënat e siguruar në teren, FOL do të punoj drejtpërdrejtë me zyrtarë publik të komunave të përzgjedhura për të përmirësuar rezultatin e tyre në angazhimin e qytetarëve, transparencën, llogaridhënien dhe procesin e përgjithshëm demokratik.

Këshillat lokal mund të kenë ndikim të madh në politikat publike lokale, në organizimin më të mirë të komuniteteve, si dhe në adresimin e nevojave të të gjithë qytetarëve në komunën përkatëse. Pavarësisht kësaj, në shumë komuna të Republikës së Kosovës ende nuk janë themeluar këshillat lokal. Ndërkaq në disa prej komunave të cilat i kanë themeluar këshillat lokal, ka mungesë të theksuar të të dhënave për anëtarët dhe kryesuesit e këtyre këshillave. Për më tepër, duke pasur parasysh shoqërinë patriarkale në Kosovë, shumë pak gra janë anëtare të këshillave lokal. Lëvizja FOL është duke analizuar gjendjen momentale në teren në mënyrë që të avokoj për përfshirjen më të madhe të grave dhe grupeve të marginalizuara në këshilla lokal.

Komunat përmes bashkëpunimit me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane sigurojnë ofrimin e shërbimeve publike në mënyrë sa më efikase. Objekt i marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërmjet komunës dhe fshatrave, vendbanimeve si dhe lagjeve urbane mund të jenë të gjitha çështjet që janë në kompetencë të komunës duke përfshirë: planifikimin urban dhe rural, furnizimin me ujë, rregullimin e kanalizimeve, shëndeti publik, mbrojtja e mjedisit, turizmi, hapësirat e hapura, varrezat, aktivitete kulturore dhe sportive etj. Andaj, rritja e bashkëpunimit mes komunës dhe këshillave lokal paraqitet si nevojë imanente për përmbushjen e nevojave të qytetarëve.

Në këtë aspekt, FOL ndër të tjera ka analizuar edhe implementimin e Ligjit nr. 03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale në përputhje me Udhëzimin Administrativ (MAPL) nr. 02/2019 për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane. Analizimi i implementimit të këtyre akteve është bërë përmes pyetësorëve dhe komunikimit me grupet e interesit.

METODOLOGJIA

FOL ka monitoruar nivelin e implementimit të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale,¹ si dhe Udhëzimin Administrativ (MAPL) nr. 02/2019 për Organizimin, Funkcionimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane² ku në mënyrë të hollësishme është shtjelluar çështja e përzgjedhjes së këshillave lokal.

Të dhënat e në lidhje me numrin e popullsisë të përdorura në këtë raport janë bazuar në të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) sipas regjistrimit të fundit të popullsisë, të bërë në vitin 2011. Të dhënat rreth përzgjedhjes së këshillave lokal janë marrë përmes komunikimit zyrtar me nivelin komunal, si dhe të dhënat e siguruara përmes hulumtimit në ueb-faqet zyrtare të komunave përkatëse. Komunat që nuk kanë kthyer përgjigje në kërkesat tona janë paraqitur me zero (0). Ndërkaq duhet të theksohet se të dhënat rreth Mitrovicës së Veriut nuk janë në dispozicion me regjistrimin e fundit të popullsisë të vitit 2011.

Sipas udhëzimit administrativ në fuqi, komunat duhet të miratojnë rregullore të reja komunale për rregullimin e këshillave lokale në përputhshmëri me kërkesat e këtij udhëzimi administrativ brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e tij.³ Ndërkaq sipas monitorimit të FOL, 15 komuna e kanë të publikuar rregulloren e re në përputhshmëri me udhëzimin administrativ të lartcekur, 10 komuna janë duke funksionuar me rregullore të vjetër që nuk janë në përputhshmëri me udhëzimin administrativ, kurse 12 komuna nuk kanë publikuar asnjë version të rregullores.

Duhet të theksohet se, pas komunikimit zyrtar me zyrtarët përgjegjës të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), janë pranuar disa të dhëna rreth statusit të implementimit të rregulloreve komunale në përputhshmëri me udhëzimin administrativ, që aktualisht është në fuqi.

Sipas të dhënave të pranuar nga MAPL, 13 komuna tashmë e kanë miratuar rregulloren e re në përputhje me kërkesat e udhëzimit administrativ, kurse komunat tjera janë ende në proces të konsultimit publik. Nga të dhënat e pranuar rreth monitorimit të MAPL-së, të dhënat rreth 11 komunave përputhen me monitorimin e FOL-it për ueb-faqe zyrtare të komunave.

Dallimet në përputhjen e të dhënave paraqiten tek Komuna e Fushë Kosovës dhe Komuna e Podujevës të cilat nga të dhënat e MAPL-së thuhet se e kanë miratuar rregullore të reja, mirëpo të njëjtat nuk janë publikuar në ueb-faqet e komunave dhe as në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Ndërsa në anën tjetër, Komuna e Graçanicës, Komuna e Kamenicës, Komuna e Vitisë dhe Komuna e Prizrenit sipas të dhënave të MAPL-së nuk përfshihen në listën e komunave që kanë miratuar rregulloret e reja, mirëpo të njëjtat komuna e kanë të publikuar këtë rregullore në ueb-faqet e tyre zyrtare.

[1] <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530>

[2] <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=21224>

[3] Po aty, neni 16.

KORNIZA LIGJORE

Ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale⁴ ka për qëllim themelimin e bazës ligjore për një sistem të qëndrueshëm të vetëqeverisjes lokale në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Ky ligj e përkufizon statusin ligjor të komunave, kompetencat, parimet e përgjithshme të financave komunale, organizimin, funksionimin e organeve komunale dhe bashkëpunimin ndër komunal, duke përfshirë bashkëpunimin ndërkufitar dhe marrëdhëniet ndërmjet komunave dhe pushtetit qendror.

Neni 34 i këtij ligji përcakton se çdo komunë mund të bëjë marrëveshje me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane brenda territorit të vet për të siguruar përmbushjen e të gjitha nevojave të të gjithë qytetarëve të komunës.

Forma e bashkëpunimit ndërmjet komunës dhe fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, si dhe fusha e punës dhe e organizimit të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, përcaktohet ndërmjet statutit dhe rregulloreve të veçanta të komunave. Ndërkaq të gjitha fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane duhet të respektojnë ligjin në fuqi gjatë kryerjes së aktiviteteve sipas marrëveshjes me komunën.⁵

Organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane për çështjet e interesit publik, i rregullon në mënyrë të detajuar Udhëzimi Administrativ (MAPL) nr. 02/2019 për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane.⁶

Këshillat lokal, në kuptim të këtij udhëzimi administrativ, janë trupat e zgjedhur që përfaqësojnë në mënyrë të organizuar komunitetin e një apo më shumë fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.⁷

Sipas nenit 4 të këtij udhëzimi, komuna themelon këshillat lokalë në bazë të numrit të banorëve, dhe atë si vijon:

- Deri në 10.000 banorë, komuna duhet të ketë deri në katër (4) këshilla lokale
- Prej 10.001 mijë deri në 20 mijë banorë, komuna duhet të ketë deri në tetë (8) këshilla lokale;
- Prej 20.001 deri në 30 mijë banorë, komuna duhet të ketë deri në dymbëdhjetë (12) këshilla lokale;
- Prej 30.001 mijë deri në 50 mijë banorë, komuna duhet të ketë deri në njëzet (20) këshilla lokale;
- Prej 50.001 mijë deri në 70 mijë banorë, komuna duhet të ketë deri në njëzet e pesë (25) këshilla lokale;
- Prej 70.001 mijë deri 100 mijë banorë, komuna duhet të ketë deri në tridhjetë (30) këshilla lokale;
- Komunat me mbi 100.001 banorë, komuna duhet të ketë deri në dyzetë (40) këshilla lokale;
- Kryeqyteti i Kosovës do të ketë deri në pesëdhjetë (50) këshilla lokal.

Për të koordinuar procesin e përzgjedhjes së këshillave lokal, Kuvendi i Komunës themelon komision të veçantë, i cili duhet të ketë 7 anëtarë, 4 prej të cilëve duhet të jenë nga Kuvendi i Komunës nga subjekte të ndryshme politike, një nga ekzekutivi, një nga shoqëria civile dhe një përfaqësues nga fshati, vendbanimi apo lagja urbane ku bëhet zgjedhja e këshillit lokal. Komisioni raporton para Kuvendit të Komunës për procesin zgjedhor.

[4] <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530>

[5] Neni 34, paragrafi 4.

[6] Udhëzimi Administrativ (MAPL) nr. 02/2019 për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane.

[7] Po aty, neni 3, paragrafi 1.1.

Për të koordinuar procesin e përzgjedhjes së këshillave lokal, Kuvendi i Komunës themelon komision të veçantë, i cili duhet të ketë 7 anëtarë, 4 prej të cilëve duhet të jenë nga Kuvendi i Komunës nga subjekte të ndryshme politike, një nga ekzekutivi, një nga shoqëria civile dhe një përfaqësues nga fshati, vendbanimi apo lagjja urbane ku bëhet zgjedhja e këshillit lokal. Komisioni raporton para Kuvendit të Komunës për procesin zgjedhor.

Këshillat lokal duhet të kenë 5 deri në 9 anëtarë.⁸ Këshilli duhet të përfshijë përfaqësimin e çdo fshati, vendbanimi apo lagjeje urbane, përfshirë edhe përfaqësimin gjinor dhe etnik. Mandati i këshillave lokal është 4 vjeçar. Mandati i kryetarit dhe anëtarëve të këshillave lokal përfundon me kryerjen e mandatit; nëse jep dorëheqje; nëse shkarkohet; nëse ndërron vendbanimin, në rast të dënimit për vepër penale me një urdhër për burgim për gjashtë (6) muaj ose më tepër, apo nëse vdes.⁹

Kryetari i Komunës në bashkëpunim me Kryesuesin e Kuvendit duhet të organizojnë së paku dy (2) takime në vit me Kryetarët e Këshillave lokale. Kryetarët e këshillave lokale, ftohen të marrin pjesë në takime konsultative, debate publike dhe konsultime publike me qytetarë.¹⁰ Sipas dispozitave të udhëzimit administrativ, bashkëpunimi i Komunës me këshillat lokale bëhet për çështjet që janë në kompetencë të komunës, si: planifikimi urban dhe rural, furnizimi me ujë, rregullimi i kanalizimit, drenazhimi, shëndetësia publike, mbrojtja lokale e ambientit, turizmi, hapësirat publike dhe varrezat, aktivitetet kulturore dhe sportive etj.

Për punën e tyre, Kryetarët e këshillave lokal kompensohen nga buxheti i komunës përkatëse. Kompensimi për kryetarët e këshillave lokal bëhet në shumën ekuivalente të anëtarëve të komiteteve obligative. Kompensimi për pjesëmarrjen në takime bëhet vetëm për gjashtë (6) takime të këshillit lokal të mbajtura brenda vitit kalendarik.¹¹

Sipas nenit 16 të këtij udhëzimi administrativ, komunat duhet të miratojnë rregullore të reja komunale për rregullimin e këshillave lokal në përputhshmëri me kërkesat e këtij udhëzimi administrativ brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e tij.

KËSHILLAT LOKAL NË KOMUNAT DERI NË 10,000 BANORË

Sipas Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 02/2019 për Organizimin, Funkzionimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane (**në tekstin e mëtejme i referohemi si: udhëzimi administrativ**), komunat deri në 10,000 banorë duhet të kenë deri në katër (4) këshilla lokal.

Sipas regjistrimit të fundit të popullsisë në vitin 2011 dhe të dhënave zyrtare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, komunat që i takojnë kësaj kategorie janë: (1) Komuna e Parteshit, (2) Komuna e Klllokotit, (3) Komuna e Ranillugit, (4) Komuna e Mamushës, (5) Komuna e Junikut, (6) Komuna e Zubin Potokut, (7) Komuna e Novobërdës, (8) Komuna e Shtërpçës, (9) Komuna e Zveçanit dhe (10) Komuna e Hanit të Elezit.

Duke u bazuar në të dhënat e paraqitura në ueb-faqet zyrtare të komunave të lartcekura, përveç Komunës së Hanit të Elezit dhe Komunës së Klllokotit,

[8] Udhëzimi Administrativ (MAPL) nr. 02/2019 për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane, neni 6.

[9] Po aty, neni 7.

[10] Po aty, neni 11.

[11] Po aty, neni 12.

Duke u bazuar në të dhënat e paraqitura në ueb-faqet zyrtare të komunave të lartcekura, përveç Komunës së Hanit të Elezit dhe Komunës së Klllokotit, të cilat e kanë të publikuar rregulloren e re komunale në përputhshmëri me kërkesat e udhëzimit administrativ dhe komuna e Novobërdës që ka të publikuar rregulloren të vjetër, komunat tjera nuk e kanë të publikuar asnjë version të rregullores komunale.

Pas komunikimit zyrtar me personat përgjegjës të këtyre komunave, përveç Komunës së Hanit të Elezit, e cila ka njoftuar se kryesuesve të këshillave lokal i'u ka mbaruar mandati, Komuna e Ranillugut dhe ajo e Mamushës kanë njoftuar që ende nuk i kanë përzgjedhur kryesuesit e këshillave lokal. Ndërkaq komunat tjera nuk kanë kthyer fare përgjigje.

Të dhënat në lidhje me numrin e fshatrave, numrin e këshillave lokal të lejuar në bazë të udhëzimit administrativ, numrin e këshillave lokal të krijuar, si dhe numrin e pjesëmarrësve burra/gra në komunat me deri në 10.000 banorë, janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

KOMUNA	NUMRI TOTAL I BANORËVE	NUMRI TOTAL I FSHATRAVE	NUMRI MAKSIMAL I LEJUAR I KËSHILLAVE LOKAL	NUMRI AKTUAL I KËSHILLAVE LOKAL	BURRA	GRA
Partesh	1,787	2	4	0	0	0
Klllokot	2,556	3	4	0	0	0
Ranillug	3,866	12	4	0	0	0
Mamushë	5,507	0	4	0	0	0
Junik	6,084	2	4	0	0	0
Zubin Potok	6,616	60	4	0	0	0
Novobërdë	6,729	25	4	0	0	0
Shtërpcë	6,949	15	4	0	0	0
Zveçan	7,481	34	4	0	0	0
Han i Elezit	9,403	10	4	0	0	0

Tabela 1.

Të dhënat në lidhje me numrin e këshillave lokale të krijuara për komunat me deri në 10,000 banorë.

Pra, nga tabela e paraqitur më sipër shihet se komunat me deri në 10.000 banorë, të cilat sipas udhëzimit administrativ në fuqi do të duhej të kishin deri në 4 këshilla lokal, aktualisht nuk ka të dhëna se e kanë ndonjë këshill lokal funksional.

KËSHILLAT LOKAL NË KOMUNAT ME 10,001 DERI NË 20,000 BANORË

Sipas udhëzimit administrativ në fuqi, komunat me 10,001 deri në 20,000 banorë duhet të kenë deri në tetë (8) këshilla lokal. Sipas regjistrimit të fundit të popullsisë në vitin 2011 dhe të dhënave zyrtare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, komunat që i takojnë kësaj kategorie janë: (1) Komuna e Graçanicës dhe (2) Komuna e Leposaviqit.

Duke u bazuar në të dhënat e siguruara në ueb-faqet zyrtare të komunave të lartcekura, Komuna e Graçanicës e ka publikuar rregulloren e re komunale, që është në përputhshmëri të plotë me kërkesat e udhëzimit administrativ në fuqi, kurse Komuna e Leposaviqit e ka të publikuar rregulloren komunale të vjetër që nuk është në përputhshmëri me kërkesat e këtij udhëzimi administrativ.

Pas komunikimit zyrtar me zyrtarët përgjegjës të këtyre komunave, asnjë nga komunat e lartcekura nuk kanë kthyer përgjigje rreth përzgjedhjes së kryesuesve të këshillave lokal.

Të dhënat në lidhje me numrin e fshatrave, numrin e këshillave lokal të lejuar në bazë të udhëzimit administrativ, numrin e kryetarëve të këshillave, si dhe numrin e pjesëmarrësve burra/gra në komunat mbi 10.001 banorë deri në 20.000 banorë, janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

KOMUNA	NUMRI TOTAL I BANORËVE	NUMRI TOTAL I FSHATRAVE	NUMRI MAKSIMAL I LEJUAR I KËSHILLAVE LOKAL	NUMRI AKTUAL I KËSHILLAVE LOKAL	BURRA	GRA
Graçanicë	10,675	16	8	0	0	0
Leposaviq	13,773	74	8	0	0	0

Tabela 2.

Të dhënat në lidhje me numrin e këshillave lokale të krijuara për komunat me nga 10,001 deri në 20,000 banorë.

KËSHILLAT LOKAL NË KOMUNAT NGA 20,001 DERI NË 30,000 BANORË

Sipas udhëzimit administrativ në fuqi, komunat me 20,001 deri në 30,000 banorë duhet të kenë deri në dymbëdhjetë (12) këshilla lokal. Sipas regjistrimit të fundit të popullsisë në vitin 2011 dhe të dhënave zyrtare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, komunat që i takojnë kësaj kategorie janë: (1) Komuna e Obiliqit dhe (2) Komuna e Shtimes.

Duke u bazuar në të dhënat e marra në ueb-faqet zyrtare të komunave të lartcekura, asnjë nga komunat nuk e kanë publikuar rregulloren e re komunale në përputhshmëri me kërkesat e udhëzimit administrativ. Komuna e Obiliqit e ka publikuar rregulloren komunale të vjetër që nuk është në përputhshmëri me kërkesat e udhëzimit administrativ, kurse Komuna e Shtimes nuk e ka publikuar asnjë version të rregullores komunale.

Pas komunikimit zyrtar me personat përgjegjës të këtyre komunave, Komuna e Obiliqit ka njoftuar se ende nuk janë përzgjedhur kryesuesit e këshillave lokal. Komuna e Shtimes ka raportuar që nga 22 fshatra sa ka në total, janë përzgjedhur 24 kryesues të këshillave lokal, pra dukshëm më tepër se sa lejohen me udhëzimin administrativ. Nga 24 kryesuesit e përzgjedhur, 22 janë burra kurse vetëm 2 janë gra.

Pavarësisht numrit të vogël të grave të zgjedhura si kryesuese të këshillave, duhet të theksohet se Komuna e Shtimes është ndër komunat e vetme e cila ka zgjedhur kryetare gra të këshillave lokal.

Të dhënat në lidhje me numrin e fshatrave, numrin e këshillave lokal të lejuar në bazë të udhëzimit administrativ, numrin e kryetarëve të këshillave, si dhe numrin e pjesëmarrësve burra/gra në komunat me mbi 20.001 banorë deri në 30.000 banorë, janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

KOMUNA	NUMRI TOTAL I BANORËVE	NUMRI TOTAL I FSHATRAVE	NUMRI MAKSIMAL I LEJUAR I KËSHILLAVE LOKAL	NUMRI AKTUAL I KËSHILLAVE LOKAL	BURRA	GRA
Obiliq	21,549	19	12	0	0	0
Shtime	27,324	22	12	24	22	2

Tabela 3.

Të dhënat në lidhje me numrin e këshillave lokale të krijuara për komunat me nga 20,001 deri në 30,000 banorë.

Nga të dhënat e paraqitur në tabelën e mësipërme, shihet se prej komunave me mbi 20.001 banorë deri në 30.000 banorë, të cilat sipas udhëzimit administrativ në fuqi do të duhej të kishin deri në 12 këshilla lokal, vetëm Komuna e Shtimes ka të themeluar këshilla lokal, ndërsa Komuna e Obiliqit nuk ka ndonjë këshill lokal funksional.

KËSHILLAT LOKAL NË KOMUNAT NGA 30,001 DERI NË 50,000 BANORË

Sipas udhëzimit administrativ në fuqi, komunat me 30,001 deri në 50,000 banorë duhet të kenë deri në njëzetë (20) këshilla lokal. Sipas regjistrimit të fundit të popullsisë në vitin 2011 dhe të dhënave zyrtare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, komunat që i takojnë kësaj kategorie janë: (1) Komuna e Kaçanikut, (2) Komuna e Dragashit, (3) Komuna e Fushë Kosovës, (4) Komuna e Kamenicës, (5) Komuna e Klinës, (6) Komuna e Istogut, (7) Komuna e Deçanit dhe (8) Komuna e Vitisë.

Duke u bazuar në të dhënat e marra në ueb-faqet zyrtare të komunave të lartcekura, Komuna e Kaçanikut, Komuna e Kamenicës, Komuna e Klinës dhe ajo e Vitisë i kanë publikuar rregulloret e reja komunale në përputhshmëri me kërkesat e udhëzimit administrativ. Komuna e Istogut, Deçanit dhe Komuna e Dragashit i kanë publikuar rregulloret e vjetra komunale, që nuk janë në përputhshmëri me kërkesat e udhëzimit administrativ, kurse Komuna e Fushë Kosovës nuk e ka të publikuar asnjë version të rregullores komunale.

Pas komunikimit zyrtar mes FOL dhe personave përgjegjës të këtyre komunave, Komuna e Dragashit nuk është përgjigjur fare në pyetjet e parashtruara, kurse Komuna e Istogut, e Klinës dhe Komuna e Fushë Kosovës kanë raportuar që ende nuk janë përzgjedhur kryesuesit e këshillave lokal.

Ndërkaq sipas përgjigjes së Komunës së Kaçanikut, nga 30 fshatrat sa kjo komunë ka në total, janë përzgjedhur 30 kryesues të këshillave lokal. Nga 30 kryesuesit e përzgjedhur, 30 janë burra dhe asnjë nuk është grua. Ndërsa Komuna e Kamenicës ka raportuar që nga 57 fshatra sa ka në total, janë përzgjedhur 27 kryesues të këshillave lokal. Nga 27 kryesuesit e përzgjedhur, 27 janë burra dhe asnjë nuk është grua.

Komuna e Deçanit ka raportuar që nga 36 fshatra sa ka në total, kanë përzgjedhur 40 kryesues të këshillave lokal. Nga 40 kryesuesit e përzgjedhur 40 janë burra dhe asnjë nuk është grua. Komuna e Vitisë ka raportuar që nga 38 fshatra sa ka në total, janë përzgjedhur 37 kryesues të këshillave lokal. Nga 37 kryesuesit e përzgjedhur 37 janë burra dhe asnjë nuk është grua.

Të dhënat në lidhje me numrin e fshatrave, numrin e këshillave lokal të lejuar në bazë të udhëzimit administrativ në fuqi, numrin e kryetarëve të këshillave, si dhe numrin e pjesëmarrësve burra/gra për komunat me mbi 30.001 banorë deri në 50.000 banorë, janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

KOMUNA	NUMRI TOTAL I BANORËVE	NUMRI TOTAL I FSHATRAVE	NUMRI MAKSIMAL I LEJUAR I KËSHILLAVE LOKAL	NUMRI AKTUAL I KËSHILLAVE LOKAL	BURRA	GRA
Kaçanik	33,409	30	20	30	30	0
Dragash	33,997	35	20	0	0	0
Fushë Kosovë	34,827	15	20	0	0	0
Kamenicë	36,085	57	20	27	27	0
Klinë	38,496	53	20	0	0	0
Istog	39,289	49	20	0	0	0
Deçan	40,019	36	20	40	40	0
Viti	46,987	38	20	37	37	0

Tabela 4.

Të dhënat në lidhje me numrin e këshillave lokale të krijuara për komunat me nga 30,001 deri në 50,000 banorë.

Pra nga të dhënat e paraqitur në tabelën e mësipërme, shihet se prej komunave me mbi 30.001 banorë deri në 50.000 banorë, të cilat sipas udhëzimit administrativ në fuqi do të duhej të kishin deri në 20 këshilla lokal, vetëm Komuna e Kaçanikut, Komuna e Kamenicës, Komuna e Deçanit dhe Komuna e Vitisë kanë themeluar këshilla lokal, ndërsa komunat tjera nuk kanë ndonjë këshill lokal funksional.

KËSHILLAT LOKAL NË KOMUNAT NGA 30,001 DERI NË 50,000 BANORË

Sipas udhëzimi administrativ në fuqi, komunat me 50,001 deri në 70,000 banorë duhet të kenë deri në njëzetë e pesë (25) këshilla lokal. Sipas regjistrimit të fundit të popullsisë në vitin 2011 dhe të dhënave zyrtare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, komunat që i takojnë kësaj kategorie janë: (1) Komuna e Skenderajt, (2) Komuna e Malishevës, (3) Komuna e Rahovecit, (4) Komuna e Lipjanit, (5) Komuna e Drenasit, (6) Komuna e Suharekës, dhe (7) Komuna e Vushtrisë.

Duke u bazuar në të dhënat e marra në ueb-faqen zyrtare të komunave të lartcekura, Komuna e Skenderajt dhe Komuna e Lipjanit i kanë publikuar rregulloret e reja komunale në përputhshmëri me kërkesat e udhëzimit administrativ. Ndërsa Komuna e Rahovecit, Drenasit, Suharekës dhe ajo e Vushtrisë i kanë publikuar rregulloret e vjetra komunale që nuk janë në përputhshmëri me kërkesat e këtij udhëzimi, kurse Komuna e Malishevës nuk e ka të publikuar asnjë rregullore komunale në lidhje me këtë çështje.

Komuna e Skenderajt ka raportuar që nga 48 fshatra sa ka në total, janë përzgjedhur 65 kryesues të këshillave lokal. Nga 65 kryesuesit e përzgjedhur 65 janë burra dhe asnjë nuk është grua. Ndërsa Komuna e Malishevës ka raportuar që nga 43 fshatra sa ka në total, i kanë përzgjedhur 46 kryesues të këshillave lokal. Nga 46 kryesuesit e përzgjedhur, 46 janë burra dhe asnjë nuk është grua.

Komuna e Rahovecit ka raportuar që nga 35 fshatra sa ka në total, janë përzgjedhur 36 kryesues të këshillave lokal. Nga 36 kryesuesit e përzgjedhur, 36 janë burra dhe asnjë nuk është grua. Komuna e Lipjanit ka raportuar që nga 61 fshatra sa ka në total, janë përzgjedhur 56 kryesues të këshillave lokal. Nga 56 kryesuesit e përzgjedhur, 56 janë burra dhe asnjë nuk është grua.

Komuna e Drenasit ka raportuar që nga 34 fshatra sa ka në total, janë përzgjedhur 44 kryesues të këshillave lokal. Nga 44 kryesuesit e përzgjedhur, 44 janë burra dhe asnjë nuk është grua. Komuna e Suharekës ka raportuar që nga 40 fshatra sa ka në total, janë përzgjedhur 44 kryesues të këshillave lokal. Nga 44 kryesuesit e përzgjedhur janë 44 burra dhe asnjë nuk është grua. Komuna e Vushtrisë ka raportuar që nga 66 fshatra sa ka në total, janë përzgjedhur 48 kryesues të këshillave lokal. Nga 48 kryesuesit e përzgjedhur, 48 janë burra dhe asnjë grua.

Të dhënat në lidhje me numrin e fshatrave, numrin e këshillave lokal të lejuar në bazë të udhëzimit administrativ, numrin e kryetarëve të këshillave, si dhe numrin e pjesëmarrësve burra/grua për komunat me mbi 50.001 banorë deri në 70.000 banorë, janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

KOMUNA	NUMRI TOTAL I BANORËVE	NUMRI TOTAL I FSHATRAVE	NUMRI MAKSIMAL I LEJUAR I KËSHILLAVE LOKAL	NUMRI AKTUAL I KËSHILLAVE LOKAL	BURRA	GRA
Skënderaj	50858	48	25	65	65	0
Malishevë	54613	43	25	46	46	0
Rahovec	56208	35	25	36	36	0
Lipjan	57605	61	25	56	56	0
Drenas	58531	34	25	44	44	0
Suharekë	59722	40	25	44	44	0
Vushtrri	69870	66	25	48	48	0

Tabela 5.

Të dhënat në lidhje me numrin e këshillave lokale të krijuara për komunat nga 50,001 deri në 70,000 banorë.

Pra nga të dhënat e paraqitur në tabelën e mësipërme, shihet se prej komunave me mbi 50.001 banorë deri në 70.000 banorë, të cilat sipas udhëzimit administrativ në fuqi do të duhej të kishin deri në 20 këshilla lokal, të gjitha kanë të themeluar këshilla lokal, të cilat e tejkalojnë dukshëm numrin e këshillave lokal të lejuar me udhëzimin e ri administrativ.

KËSHILLAT LOKAL NË KOMUNAT NGA 70,001 DERI NË 100,000 BANORË

Sipas udhëzimit administrativ në fuqi, komunat me 70,001 deri në 100,000 banorë duhet të kenë deri në tridhjetë (30) këshilla lokale. Sipas regjistrimit të fundit të popullsisë në vitin 2011 dhe të dhënave zyrtare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, komunat që i takojnë kësaj kategorie janë: (1) Komuna e Mitrovicës, (2) Komuna e Podujevës, (3) Komuna e Gjilanit, (4) Komuna e Gjakovës dhe (5) Komuna e Pejës.

Duke u bazuar në të dhënat e marra në ueb-faqet zyrtare të komunave të lartcekura, Komuna e Mitrovicës, Gjakovës dhe ajo e Pejës e kanë të publikuar rregulloren e re komunale në përputhshmëri me kërkesat e udhëzimit administrativ, kurse Komuna e Podujevës gjendet në fazën e konsultimit publik. Komuna e Gjilanit e ka të publikuar rregulloren e vjetër komunale që nuk është në përputhshmëri me kërkesat e udhëzimit administrativ.

Komuna e Podujevës ka raportuar që kryesuesve të këshillave lokal iu ka kaluar mandati dhe ende nuk i kanë përzgjedhur kryesuesit e rinj të këshillave lokal. Ndërsa Komuna e Mitrovicës ka raportuar që nga 45 fshatra sa ka në total, janë përzgjedhur 42 kryesues të këtyre këshillave lokal. Nga 42 kryesuesit e përzgjedhur janë 42 burra dhe asnjë grua. Komuna e Gjilanit ka raportuar që nga 48 fshatra sa ka në total, janë përzgjedhur 13 kryesues të këshillave lokal. Nga 13 kryesuesit e përzgjedhur 13 janë burra dhe asnjë grua.

Komuna e Gjakovës dhe ajo e Pejës përveç që e kanë të publikuar rregulloren e re komunale në përputhshmëri me kërkesat e udhëzimit administrativ, këto dy komuna janë duke e

respektuar implementimin e saj me të gjitha dispozitat e tij. Komuna e Gjakovës ka raportuar që nga 87 fshatra sa ka në total, janë përzgjedhur 30 kryesues të këshillave lokal. Nga 30 kryesuesit e përzgjedhur 30 janë burra dhe asnjë nuk është grua. Komuna e Pejës ka raportuar që nga 78 fshatra sa ka në total, i ka përzgjedhur 30 kryesues të këshillave lokal. Nga 30 kryesuesit e përzgjedhur 27 janë burra dhe vetëm 3 gra.

Pra, duhet të theksohet se, përkundër numrit të vogël të grave të zgjedhura si kryesuese, Komuna e Pejës është komuna me më së shumti gra kryesuese të zgjedhura për këshillat lokal (3 gra).

Të dhënat në lidhje me numrin e fshatrave, numrin e këshillave lokal të lejuar në bazë të udhëzimit administrativ, numrin e kryetarëve të këshillave, si dhe numrin e pjesëmarrësve burra/grat për komunat me mbi 70.001 banorë deri në 100.000 banorë, janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

KOMUNA	NUMRI TOTAL I BANORËVE	NUMRI TOTAL I FSHATRAVE	NUMRI MAKSIMAL I LEJUAR I KËSHILLAVE LOKAL	NUMRI AKTUAL I KËSHILLAVE LOKAL	BURRA	GRA
Mitrovicë	83935	46	30	65	42	0
Podujevë	88499	76	30	46	0	0
Gjilan	90178	48	30	36	13	0
Gjakovë	94556	87	30	56	30	0
Pejë	96450	78	30	44	27	3

Tabela 6.

Të dhënat në lidhje me numrin e këshillave lokal të krijuara për komunat me nga 70,001 deri në 100,000 banorë.

Pra nga të dhënat e paraqitur në tabelën e mësipërme, shihet se prej komunave me mbi 70.001 banorë deri në 100.000 banorë, të cilat sipas udhëzimit administrativ në fuqi do të duhej të kishin deri në 30 këshilla lokal, përveç Komunës së Podujevës, të gjitha komunat tjera i kanë themeluar këshillat lokal. Komuna e Gjakovës dhe Komuna e Pejës, që bëjnë pjesë në këtë kategori, janë komunat e vetme që këshillat lokal i kanë themeluar plotësisht në përputhje me udhëzimin e ri administrativ.

KËSHILLAT LOKAL NË KOMUNAT ME MBI 100,001 BANORË

Sipas udhëzimit administrativ, komunat me mbi 100,001 banorë duhet të kenë deri në dyzetë (40) këshilla lokal. Sipas regjistrimit të fundit të popullsisë në vitin 2011 dhe të dhënave zyrtare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës komunat që i takojnë kësaj kategorie janë: (1) Komuna e Ferizajt dhe (2) Komuna e Prizrenit.

Duke u bazuar në të dhënat e marra nga ueb-faqja zyrtare e komunave të sipër cekura, të dy komunat e kanë të publikuar rregulloren e re komunale në përputhshmëri me kërkesat e udhëzimit administrativ.

Komuna e Ferizajt ka raportuar që nga 44 fshatra sa ka në total, i ka përzgjedhur 51 kryesues të këshillave lokal. Nga 51 kryesuesit e përzgjedhur 51 janë burra dhe asnjë nuk është grua. Pavarësisht që Komuna e Ferizajt e ka të publikuar rregulloren e re, në rregullore e ka të definuar që numri i këshillave lokal duhet të jetë 51 e që nuk është në përputhje me kërkesat e udhëzimit administrativ, që përcakton se komunat me mbi 100,001 banorë duhet të kenë deri në 40 këshilla lokal.

Komuna e Prizrenit ka raportuar që nga 75 fshatra sa ka në total, janë përzgjedhur 77 kryesues të këshillave lokal. Nga 77 kryesuesit e përzgjedhur, 75 janë burra dhe vetëm 2 janë gra. Pra edhe Komuna e Prizrenit është një ndër komunat e vetme që ka të përzgjedhur kryesuese femra të këshillave lokal.

Të dhënat në lidhje me numrin e fshatrave, numrin e këshillave lokal të lejuar në bazë të udhëzimit administrativ, numrin e kryetarëve të këshillave, si dhe numrin e pjesëmarrësve burra/gra për komunat me mbi 100.001, janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

KOMUNA	NUMRI TOTAL I BANORËVE	NUMRI TOTAL I FSHATRAVE	NUMRI MAKSIMAL I LEJUAR I KËSHILLAVE LOKAL	NUMRI AKTUAL I KËSHILLAVE LOKAL	BURRA	GRA
Ferizaj	108,810	44	40	51	51	0
Prizren	177,781	75	40	77	75	2

Tabela 7.

Të dhënat në lidhje me numrin e këshillave lokal të krijuara për komunat me mbi 100,001 banorë.

KËSHILLAT LOKAL NË KRYEQYTETIN E KOSOVËS

Sipas udhëzimit administrativ në fuqi, Kryeqyteti i Kosovës duhet të ketë deri në pesëdhjetë (50) këshilla lokal.

Pavarësisht numrit të madh të këshillave lokal që kjo komunë mund të ketë, gjatë hulumtimit në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Prishtinës nuk janë gjetur të dhëna në lidhje me ekzistimin ose jo të ndonjë këshilli lokal në këtë komunë. Cjithashtu, në ueb-faqen zyrtare të kësaj komune shihet se kjo komunë nuk ka miratuar rregullore te re për funksionimin dhe administrimin e këshillave lokal, në përputhje me udhëzimin e ri administrativ, por e njëjta funksionon me rregulloren e vjetër, që nuk është në përputhshmëri me udhëzimin administrativ.

Po ashtu, edhe gjatë komunikimit me zyrtarët përgjegjës të kësaj komune, Lëvizja FOL nuk ka arritur të siguroj ndonjë përgjigje rreth numrit të përzgjedhur të këshillave lokal të Komunës së Prishtinës, apo se ku gjendet procesi momental rreth krijimit të tyre.

Të dhënat në lidhje me numrin e fshatrave, numrin e këshillave lokal të lejuar në bazë të udhëzimit administrativ, numrin e kryetarëve të këshillave, si dhe numrin e pjesëmarrësve burra/gra në Kryeqytetin e Kosovës, janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

KOMUNA	NUMRI TOTAL I BANORËVE	NUMRI TOTAL I FSHATRAVE	NUMRI MAKSIMAL I LEJUAR I KËSHILLAVE LOKAL	NUMRI AKTUAL I KËSHILLAVE LOKAL	BURRA	GRA
Prishtina	198,897	42	50	0	0	0

Tabela 8.

Të dhënat në lidhje me numrin e banorëve, numrin e fshatrave dhe numrin e këshillave lokal të krijuara në Kryeqytetin e Kosovës.

PËRFUNDIME

Këshillat lokal mund të kenë rol të madh në përfshirjen e të gjithë qytetarëve në procesin e zhvillimit të politikave lokale, në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve për qytetarët, si dhe përfshirjen e të gjitha komuniteteve në temat që prekin interesin e tyre, prandaj monitorimit të themelimit dhe administrimit të tyre duhet të i kushtohet kujdes i veçantë.

Sipas monitorimit të FOL, nga 38 Komunitet e Kosovës, 14 komuna (Prizren, Pejë, Ferizaj, Gjakovë, Mitrovicë, Skenderaj, Kamenicë, Hani i Elezit, Lipjan, Klinë, Kaçanik, Viti, Klllokot, Graçanicë) i kanë të publikuara në ueb-faqet e tyre zyrtare versionet e reja të rregulloreve komunale për organizimin dhe funksionimin e këshillave lokal, të cilat janë në përputhshmëri me kërkesat e udhëzimit administrativ në fuqi. Nga komunitet që i kanë publikuar rregulloret e reja, vetëm 2 komuna (Komuna e Gjakovës dhe Komuna e Pejës) janë duke e implementuar plotësisht rregulloren e re në praktikë.

13 komuna (Deçan, Istog, Dragash, Obiliq, Leposaviç, Rahovec, Prishtinë, Suharekë, Vushtrri, Glllogoc, Podujevë, Gjilan dhe Novobërdë) janë duke funksionuar me rregulloret e vjetra, që nuk janë në përputhshmëri me udhëzimin administrativ në fuqi. 11 komuna (Fushë Kosovë, Partesh, Shtime, Shtërpç, Zveçan, Zubin Potok, Mitrovicë e Veriut, Junik, Mamushë, Malishevë, Ranillugë) nuk kanë publikuar asnjë version të rregulloreve.

Rreth statusit të përzgjedhjes së këshillave lokal, sipas të dhënave të dërguara nga zyrtarët përgjegjës të komunave, nga gjithsej 38 Komunitet e Kosovës, 18 prej tyre (apo 47 %) i kanë themeluar këshillat lokal të cilat janë duke funksionuar normalisht, 8 komuna (apo 8%) kanë raportuar që këshillave lokale ju ka kaluar mandati, apo se ende nuk janë zgjedhur, kurse 12 komuna (apo 31%) nuk kanë kthyer fare përgjigje rreth statusit të themelimit dhe funksionimit të këshillave lokal. Ndërkaq duhet të theksohet se për Komunitetin e Prishtinës, e cila do të duhej të kishte deri në 50 këshilla lokal, gjatë hulumtimit në ueb-faqen zyrtare të saj nuk janë gjetur të dhëna në lidhje me funksionimin ose jo të ndonjë këshilli lokal.

Sipas të dhënave të siguruar nga FOL, nga 740 kryesuesit e zgjedhur të këshillave lokal, 733 prej tyre, apo 99 % janë burra, kurse vetëm 7 janë gra (përkatësisht vetëm 1%). Komunitet të cilët kanë zgjedhur kryetare gra të këshillave lokal janë: Komuna e Pejës (me 3 gra kryetare të këshillave), Komuna e Shtimes dhe Komuna e Prizrenit (me nga 2 gra kryetare të këshillave).

FOL gjatë hulumtimit gjithashtu ka identifikuar mungesë të theksuar të koordinimit mes nivelit qendror dhe lokal. FOL i rekomandon Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal që të koordinohet me Asociacionin e Komunave të Kosovës rreth aprovimit të rregulloreve të reja komunale për përzgjedhjen e këshillave lokal, si dhe themelimit dhe funksionimit të këshillave lokal në përputhshmëri me rregulloren komunale, udhëzimit administrativ dhe ligjit për vetëqeverisje lokale.

Të dhënat nga ky hulumtim do të përdoren nga FOL për mbarëvajtjen e aktiviteteve pasuese të këtij projekti. FOL do të organizoj shtatë (7) diskutime "FOL Hapur" me kryetarët e komunave të cilat ende nuk kanë filluar të implementojnë Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, trajnime për zyrtarët komunal rreth përfshirjes më të madhe të qytetarëve në vendimmarrje, trajnime rreth organizatave të shoqërisë civile për të shërbyer si urë lidhëse mes qytetarëve dhe institucioneve lokale, si dhe sesione informuese për qytetarët rreth të drejtave të tyre dhe mekanizmat që i kanë në dispozicion për tu përfshirë në vendimmarrje.